

01/ZDP/VE/2024  
Datë: 30 janar 2024

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019) dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) 05/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë (më tutje Rregullorja),

Duke vepruar në bazë të kërkesë të subjektit afarist "ExFis" sh.p.k. për zgjatje të aprovimit si furnizues për palë të treta i shërbimeve në tokë për kategorinë 7.1 të shtojcës së Rregullores 04/2011, me ndryshime,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

#### V E N D I M

1. **VAZHDOHET** deri më 31 janar 2025 aprovimi i subjektit afarist "ExFis" sh.p.k. NRB 70272163, si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" për furnizim të aeroplanëve me derivate.
2. **OBLIGOHET** subjekti nga pika 1 e këtij Vendimi që gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve t'iu përmbahet me përpikëri dispozitave të Rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 dhe akteve tjera normative në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi më 01 shkurt 2024.

#### Arsyetim

Subjekti afarist "ExFis" sh.p.k. ka dorëzuar në AACK me dt. 15 nëntor 2018 aplikacionin përmes së cilit ka kërkuar vazhdimin e aprovimin e tij si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" për furnizimin e aeroplanëve me derivate ( kategorinë 7.1 të shtojcës së Rregullores).

Nga data e aplikimit deri më tani janë lëshuar për operatorin "ExFis" shpk, aprovimet për zgjatje të përkohshme, si vijon: Vendimi nr. 01/ZDP/VE/2019 dt. 08.01.2019, Vendimi nr. 03/ZDP/VE/2019 dt. 14.02.2019, Vendimi nr. 03/ZDP/VE/2019 dt. 14.02.2019, Vendimi 25/ZDP/VE/2019 dt. 14.08.2019, Vendimi 27/ZDP/VE/2019 dt. 30.09.2019, Vendimin 31/ZDP/VE/2019 dt. 27.12.2019, Vendimi 01/ZDP/VE/2020 dt. 30.01.2020, Vendimi 03/ZDP/VE/2020 dt. 30.03.2020, Vendimi nr. 07/ZDP/VE/2020 dt. 29.07.2020, Vendimi me nr. 02/ZDP/VE/2022, dt. 27 janar 2022, dhe Vendimi me nr. 01/ZDP/VE/2023, dt. 31.01.2023. Aprovimet e lartpërmendura për zgjatje të përkohshme të aprovimit për operatorin "Ex Fis" shpk janë lëshuar me qëllim që organi menaxhues i aeroportit të krijoj kushtet për hapje të tregut në përputhje me kërkesat rregullatore.



Më dt. 29 janar 2024, Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar konfirmin nga Departamenti i Aerodromeve dhe Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit, që operatori në fjalë është subjekt i mbikëqyrjes së rregullt dhe bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes, ky subjekt nuk ka të hapur asnjë mospërputhshmëri lidhur me përmbushjen e kërkesave rregullatore të sigurisë, respektivisht që subjekti në fjalë ka mirëmbajtur gjatë gjithë kohës kriteret ekonomike në bazë të të cilave është aprovuar.

Për shkak të mos krijimit të kushteve për hapje të tregut për shërbime të tokë në përputhje me Rregulloren 04/2011, të ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së i është drejtuar me shkresa me dt. 17.07.2020 dhe dt. 27.07.2020, Komitetit për Partneritet Publiko Privat, si partner publik i Marrëveshjes për PPP, që të sqarojnë këtë çështje me organin menaxhues të aeroportit në mënyrë që të hapet rruga për zbatim të kërkesave rregullatore. Po ashtu gjatë vitit 2021 dhe 2022 në mënyrë të vazhdueshme AAC e ka adresuar tek Komiteti PPP dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, mos respektimin Rregulloren Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë nga organi menaxhuar i Aeroportit, si dhe refuzimin e organit menaxhues të Aeroportit për të zbatuar Vendimit 01/ZDP/VE/2021 që ndërlidhet me aplikimin e tarifës ndaj operatorit "ExFis" shpk.

Përderisa organi menaxhues i aeroportit LKIA sh.a. nuk bënë plotësimin e kushteve të parapara në këtë Rregullore lidhur me menaxhimin e infrastrukturës së centralizuar, të cilat kërkesa janë potencuar edhe përmes Vendimit 01/ZDP/VE/2021, të datës 19 janar 2021, aprovimi, sipas nenit 10 të Rregullores 04/2011, të ndryshuar dhe plotësuar, mund të vazhdohet vetëm për periudhë të përkohshme.

Deri në implementimin e Rregullores, specifikisht nenin 8 të kësaj Rregulloreje dhe Vendimit 01/ZDP/VE/2021, AAC do të lëshon aprovime të përkohshme për ofrues të shërbimeve në tokë me kohëzgjatje një (1) vjeçare, me qëllim të mbrojtjes së interes publik. AAC do të vazhdoj përmes auditimeve në mënyrë të vazhdueshme të bëjë monitorimin e kërkesave rregullatore të sigurisë dhe tyre financiare.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, lidhur me Rregulloren nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019, vendimeve paraprake për vazhdim të përkohshëm si dhe Vendimit 01/ZDP/VE/2021, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

**Alban Ramabaja**  
UD Drejtor i Përgjithshëm



Iu dërgohet:

- ExFis Sh.p.k. Blvd. Bill Killinton AB7, 1000, Prishtinë;
- Organit Menaxhues të ANP "Adem Jashari" LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Ministrin të MMPHI;
- Arkivit të AAC-së.